



## VENDIMI I PAPRANUESHMËRISË

**Data e miratimit:** 08.06.2011

**Nr. i rastit:** 2010-09

**Burim Ramadani**

Kundër

**EULEX-it – Komponenti i Drejtësisë**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 08 qershor 2011, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, Kryesues  
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare  
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Asistuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore  
Znj. Stephanie SELG, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PARA PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar më 10 shtator 2010.

## II. FAKTET

### *Parathënie*

2. Më datën 20 gusht 2001, pesë anëtarë të familjes Hajra ishin qëlluar për vdekje në veturën e tyre gjatë një pusie afër Gllgovcit. Një prej anëtarëve të kësaj familje i shpëtoj sulmit. Hamëz Hajra, babai i familjes, ishte sulmuar edhe më herët, në pranverë të vitit 1998.

### *Procedurat penale të shkallës së parë dhe të dytë*

3. Më 3 korrik 2002 dhe më 11 shtator 2002, një prokuror kishte ngritur akuzë ndaj dy të dyshuarve në lidhje me tentim vrasjen që kishte ndodhur në vitin 1998.
4. Më 7 shkurt 2003, shtatë të dyshuar ishin akuzuar, në mesin e krime të tjera, për vrasje si dhe për tentim vrasje të vitit 2001. Katër persona të tjerë ishin akuzuar për veprimtari që lidhen me vrasje, siç janë dhënia e ndihmës dhe bashkëfajësia në mënyra të ndryshme.
5. Më 16 shtator 2003 të gjitha paditë ishin bashkuar, kështu procedurat e vitit 1998 dhe 2001 u bashkuan në një procedurë kundër gjithsej 12 të dyshuarve.
6. Më 7 tetor 2003, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP), kishte vendosur të ndryshojë vendin e gjykimit, nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës në Gjykatën e Qarkut të Gjilanit.
7. Gjyqi filloi më 4 nëntor 2003 në Gjykatën e Qarkut të Gjilanit dhe u zhvilluan gjithsej 107 seanca dëgjimore gjatë këtij gjykimi.
8. Më 7 prill 2005, Gjykata e Qarkut e Gjilanit kishte dënuar të gjithë prej 12 të dyshuarve, dhe i dënoi ata me burgim prej 2 vjet deri në 30 vjet. Disa akuza ishin hedhur poshtë gjatë procesit.
9. Më 20 Maj 2008, Gjykata Supreme e Kosovës kishte mbajtur një seancë, ku kishte liruar disa të pandehur nga disa akuza dhe të tjerë të pandehur nga të gjitha akuzat. Disa dënime ishin ndryshuar nga pak. Paneli ishte i përbërë nga tre gjykatës ndërkombëtarë.

### *Procedurat e Apelit para Gjykatës Supreme*

10. Avokatët e katër të pandehurve ishin ankuar tek Gjykata Supreme në gusht dhe shtator të vitit 2008 duke pretenduar se ka pasur shkelje procedurale, përcaktim jo të plotë të fakteve, shkelje të legjislacionit dhe dënime të larta me burg.
11. Ky rast ishte bartur nga UNMIK-u tek EULEX-i në janar të vitit 2009. Gjykata Supreme e Kosovës ka mbajtur një seancë apeli në shtator të vitit 2009 në përbërje të tre gjyqtarë ndërkombëtarë dhe dy gjyqtarë vendorë në trupin gjykues.

12. Më 16 shtator 2009, Gjykata Supreme e Kosovës kishte hedhur poshtë ankesat e tre të pandehurve si të pabaza dhe kishte hedhur poshtë ankesën e të pandehurit të katërt si të papranueshme.
13. Në të njëjtën kohë, Gjykata Supreme e Kosovës, e vërtetoi plotësisht vendimin e saj të mëparshme, që i kishte dënuar të tre të pandehurit kryesor, secilin me nga 30 vjet në burg dhe të pandehurin e katërt me 11 vite në burg.
14. Nuk kishte mundësi ankese kundër këtij aktvendimi. Mundësia e vetme për ta apeluar këtë aktvendim ishte një kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, e cila duhej të paraqitej në gjykatën, ku ishte marrë vendimi i shkallës së parë, brenda 3 muajve nga marrja e vendimit përfundimtar.

*Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë*

15. Të gjithë prej katër të pandehurve kishin paraqitur kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë pranë Gjykatës së Qarkut në Gjilan kah fundi i vitit 2009 dhe në fillim të vitit 2010. Ata pretenduan se ka pasur shkelje të konsiderueshme të procedurës penale, papranueshmëri të disa provave dhe deklaratave si dhe, në mesin e ankese të tjera, edhe mos respektim të legjislacionit.
16. Më 1 shkurt 2011, Gjykata Supreme, në përbërje prej tre gjykatësve ndërkombëtarë dhe dy gjykatësve vendorë, ka hedhur poshtë kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabaza, sa i përket të gjitha prej tre vendimeve të mëparshme në lidhje me katër të pandehur.
17. Në të njëjtën kohë, Gjykata Supreme rivërtetoi aktgjykimin e datës 20 maj 2008, e cila ishte vërtetuar më herët më 16 shtator 2009 nga Gjykata Supreme, si gjykatë e shkallës së dytë.

### **III. ANKESAT**

18. Parashtruesi i ankesës pretendon se ka pasur shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNj, 1950).
19. Përveç kësaj, ai pohon se neni 29 (e drejta për liri dhe siguri) dhe neni 31 (e drejta për proces të rregullt) në Kushtetutën e Kosovës janë shkelur.
20. Ai pretendon se trupi gjykues, në përbërje prej shumicës së gjykatësve të EULEX-it, nuk e kanë marrë vendimin duke u bazuar në ligj dhe se gjyqi ishte i padrejtë, i njëanshëm dhe joprofesionale. Si pasojë e kësaj, edhe Kodi Penal i Kosovës ishte shkelur.
21. Parashtruesi i ankesës kërkon nga Paneli të bëjë këto rekomandime:

- që të shfuqizoj vendimin e datës 16 shtator 2009 të marrë nga Gjykata Supreme e Kosovës dhe të zëvendësoj atë me një vendim të drejtë dhe të paanshëm, dhe;
- që të gjej provat materiale që supozohet se kanë humbur nga UNMIK-u gjatë hetimeve fillestare.

#### IV. LIGJI

22. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos se a ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriterin e pranueshmërisë të përcaktuar në Rregullën 29 të Rregullores së Punës.
23. Kjo ankesë iu është parashtruar Panelit më 10 shtator 2010, nga gazetarja Sebahate Shala në emër të z. Burim Ramadanit, nën mbështetjen e Këshillit organizativ "Drejtësi për rastin Kiçina".
24. Vendimi rreth bazueshmërisë së rastit të parashtruesit të ankesës ishte marrë më 16 shtator 2009 nga Gjykata Supreme. Më pastaj, kërkesa e parashtruesit të ankesës për mbrojtje të ligjshmërisë u cilësua e pabazë nga Gjykata Supreme më 1 shkurt 2011.
25. Sipas Rregullës 25, paragrafi 3 i Rregullores së Punës, ankesat duhet të dorëzohen tek Paneli brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar. Prandaj, Paneli konsideron se kjo ankesë e cila është parashtruar më 10 shtator 2010, është parashtruar me kohë.
26. Sipas Rregullës 25, paragrafi 1 i Rregullores së Punës, një ankesë mund të dorëzohet tek Paneli nga çdo person, përveç personelit të EULEX-it në Kosovë, i cili pretendon se është viktimë e ndonjë shkelje të të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë, gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
27. Kjo ankesë ka të bëjë me një kërkesë për ta ndryshuar një vendim përfundimtar të marrë nga Gjykata Supreme e Kosovës.
28. Paneli vë në dukje se nuk ka mandat për të ndryshuar ndonjë vendim të marrë nga ndonjë gjykatë e Kosovës. Ky Panel nuk është gjykatë e apelit kundër vendimeve të marra nga gjykatat e Kosovës. Mandati i tij nuk përfshin shqyrtimin e gabimeve të fakteve apo ligjit që supozohet se mund të jenë kryer nga këto gjykata. Nuk është detyrë e Panelit që t'i shqyrtoj vendimet e marra nga gjykatat e Kosovës lidhur me pranueshmërinë apo vlerësimin e provave.

**PËR KËTO ARSYE,**

Paneli, njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, konstaton se sipas Nenit 29 (d) të Rregullores së Punës ankesa është e pabazuar, dhe

**SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor

Antonio BALSAMO  
Kryesues i Panelit